



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za
Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science
&Technology*

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

Udhëzim Administrativ
Ekipi Komunal për Grante Shkollore (EKGSH)

Numër: 12/2010

Datë: 08.03.2010

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4.3 dhe 42.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të MASHT-it dhe Bankës Botërore të mbështesë zbatimin e Projektit për Zhvillimin Institucional të Arsimit (Granti IDEP, nr. KOS-IDEP H3420), përkatësisht realizimin e komponentës 1.3 të projektit "Grantet për zhvillimin e shkollave", i cili do të ofrojë financim të drejtpërdrejtë nga Banka Botërore për shkollat e zgjedhura brenda Kosovës. Ekipi Komunal për Grante Shkollore (EKGSH) formohet në secilën komunë që merr pjesë në projekt dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të procesit të granteve që komunën përkatëse.
2. EKGSH është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të zhvillimit dhe vlerësimin të planeve për zhvillim të shkollave, zhvillimin dhe zbatimin e projekt-propozimeve për grante shkollore nëpër komuna. Kriteret e zgjedhjes të cilat do të shfrytëzohen dhe procesi i cili do të zhvillohet, është i detajuar në Doracakun për Grante Shkollore të

projektit. Secila komunë (gjegjësisht EKGSH) do të marrë Doracakun për Grante Shkollore nga Ekipi Koordinues i Projektit.

Neni 2 Shkurtesat

1. **EKGSH:** Ekipi Komunal për Grante Shkollore
2. **KAGSH:** Këshilli për Aprovimin e Granteve të Shkollave
3. **EKP:** Ekipi Koordinues i Projektit
4. **IDEP:** Institutional Development for Education Project (Projekti për Zhvillimin Institucional të Arsimit)
5. **DGSH:** Doracaku i Granteve Shkollore që është doracak operativ, i cili do të përdoret për ta lehtësuar realizimin e komponentës 1.3 të projektit
6. **KEC:** Qendra për Arsim e Kosovës
7. **BPT:** Bashkëpunëtori profesional i terrenit për grante. Ai/ajo është bashkëpunëtor në nivel rajoni, i punësuar nga KEC-i, dhe është përgjegjës për të ndihmuar në realizimin e projektit në nivel shkolle dhe komune.

Neni 3 Përbërja e EKGSH-ve

1. EKGSH-të përbëhen prej katër (4) anëtarëve kryesorë me detyra dhe përgjegjësi të caktuara. EKGSH-ja, gjithashtu, mund të ketë tre deri në pesë përfaqësues të tjerë ndihmës të komunës përkatëse, të cilët do të ftohen nga MASHT-i apo ndonjë entitet tjetër i autorizuar për të marrë pjesë dhe për të ofruar kontribut shtesë.
2. Anëtarët kryesorë të EKGSH-së me të drejtë vote janë:
 - 2.1. Drejtori komunal i arsimit;
 - 2.2. Zyrtari i MASHT-it;
 - 2.3. Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve i komunës përkatëse, i emëruar nga Komiteti Prindërve i Arsimit i Kosovës; dhe
 - 2.4. Bashkëpunëtori profesional i terrenit për Grante Shkollore, i cili nuk ka të drejtë vote).
3. Përfaqësues të tjerë ndihmës të EKGSH-së mund të jenë:
 - 3.1. Përfaqësuesi i Qendrës Komunale për Mirëqenie Sociale;
 - 3.2. Përfaqësuesi i ndonjë OJQ-je që është aktive dhe zhvillon aktivitete në fushën e arsimit parauniversitar;
 - 3.3. Përfaqësuesi i zyrës lokale të HANDIKOS-it;
 - 3.4. Ndonjë palë tjetër e interesuar;
 - 3.5. EKGSH-ja, në çdo mbledhje, fton së paku dy prej anëtarëve ndihmës për të marrë pjesë në mbledhje si vëzhgues. Këta anëtarë mund të sugjerojnë dhe t'u japin këshilla anëtarëve të rregullt, por ata nuk kanë të drejtë vote.

Neni 4 **Procedurat e funksionimit të EKGSH-së**

1. EKGSH duhet t'i ndjekë procedurat standarde të mbledhjeve. Disa nga rregullat procedurale janë dhënë në vijim:
 - 1.1. DKA është kryesues i EKGSH-së dhe duhet t'i udhëheqë mbledhjet.
 - 1.2. Çështjet normalisht duhet të rregullohen përmes konsensusit. Në rast se konsensusi nuk është i mundur, atëherë vendimi i fundit duhet të merret nga anëtarët kryesorë përmes votimit. Vendimi i anëtarëve kryesorë duhet të jetë përfundimtar.
 - 1.3. Çdo anëtar i EKGSH-së duhet të kundërshtojë çfarëdo vendimi apo çështje që konsideron se ai/ajo ka konflikt interesash.
 - 1.4. Takimet e EKGSH-së janë të vlefshme vetëm atëherë kur të gjithë anëtarët kryesorë janë të pranishëm.
 - 1.5. Vendimet e EKGSH duhet të evidentohen me shkrim përmes procesverbalit dhe të nënshkruhen prej DKA-së.
 - 1.6. Mbledhjet e EKGSH-së duhet të mbahen sipas nevojës. Sqarime më të detajuara rreth aktiviteteve të EKGSH-së janë dhënë në Doracakun e Granteve Shkollore (DGSH).

Neni 5 **Zgjedhja e shkollave**

1. Funksioni kryesor i EKGSH-së do të jetë zgjedhja e shkollave (përgatitja e listës preliminare) për të marrë pjesë në projekt. Gjatë zgjedhjes së shkollave, EKGSH-ja do të mbështetet në kriteret e zgjedhjes dhe proceset e cekura në Doracakun e Granteve (DGSH), i miratuar nga KAGSH-ja (Këshilli për Arovimin e Granteve Shkollore). Detyrat kryesore përfshijnë:
 - 1.1. Drejtori komunal i arsimit (DKA) mbledh informata prej SMIA-s apo burime të tjera (përfshirë edhe prej drejtorëve të shkollave) që duhen për t'i përmbushur treguesit e listës së shkurtër preliminare të parapara në DGSH.
 - 1.2. DKA-ja mbledh informacione prej drejtorit të Mirëqenies sociale sa i përket përqindjes së familjeve që marrin asistencë sociale në zonën që e mbulon shkolla përkatëse, për t'i ndihmuar që t'i radhisë shkollat sipas treguesit të varfërisë.
 - 1.3. DKA-ja dhe përfaqësuesi i MASHT-it e përgatisin listën për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në komunën përkatëse të radhitura sipas 5 treguesve fillestarë të paraparë në DGSH. Sipas radhëtjes, ata e përgatisin listën e shkurtër preliminare të pesëdhjetë përqind të shkollave fillore dhe të mesme.
 - 1.4. DKA-ja do t'i ketë parasysh shkollat prej zonave rurale dhe ato do të zgjidhen duke u bazuar në largësi prej qendrës.
 - 1.5. DKA-ja e thërret takimin e EKGSH-së për ta rishikuar listën e shkurtër preliminare sipas kriterëve të zgjedhjes që po ashtu janë të përshkruara në DGSH. Nga ky takim përgatitet lista e rishikuar e radhitur sipas kriterëve të zgjedhjes, së bashku me rekomandimet se cilat shkolla duhet të përfshihen në ciklin e granteve.

- 1.6. EKP-ja i shqyrton rekomandimet e EKGSH-së për zgjedhjen e shkollave dhe ia paraqet ato KAGSH-së për miratim.
- 1.7. EKP-ja e njofton EKGSH-në (përmes DKA-së apo BPT-së) për miratimin e listës së shkollave të zgjedhura (ose të kundërtën) të cilat marrin pjesë në projektin e granteve shkollore në kuadër të projektit IDEP.

Neni 6

Procesi i zbatimit të projekt-propozimeve të granteve shkollore

- 1. EKGSH-ja është përgjegjëse gjithashtu edhe për mbikëqyrjen e përgjithshme të zhvillimit dhe vlerësimit të planeve për zhvillimin e shkollës dhe projekt-propozimeve për grante shkollore në kuadër të projektit IDEP. Të gjitha këto procese janë të cekura në Doracakun për Grante Shkollore. Procesi do të përfshijë detyrat në vijim:
 - 1.1. Bashkëpunëtori profesional do të organizojë trajnim mbi ndërtimin e kapaciteteve për shkollat e zgjedhura si dhe për Këshillat e shkollave.
 - 1.2. Shkollat e zgjedhura do të zhvillojnë planet për zhvillimin e shkollës dhe projekt-propozimet për grante shkollore.
 - 1.3. Këshillat e shkollave të zgjedhura do të marrin në konsideratë projekt-propozimet për grante shkollore dhe nëse i përmbushin kërkesat e parapara do t'i aprovojnë ato.
 - 1.4. DKA-ja do t'i vlerësojë projekt-propozimet në bazë të kriterëve të vlerësimit të dhëna në Doracakun për Grante Shkollore.
 - 1.5. DKA-ja do t'ia bashkangjijë projekt-propozimit analizat e buxhetit të shkollave, në nivel komune, për mallra dhe shërbime.
 - 1.6. EKGSH-ja do ta nënshkruajë vlerësimin e projekt-propozimeve për grante shkollore dhe do të bëjë ndonjë rekomandim nëse konsideron se ka nevojë.
 - 1.7. DKA-ja ia dorëzon KAGSH-së, përmes EKP-së, këto projekt-propozime për grante shkollore, së bashku me rekomandimet nga EKGSH-ja.

Neni 7

Mbështetja për zbatimin dhe monitorimin e projektit në nivel shkolle

- 1. EKGSH-ja është përgjegjëse për mbështetjen e zbatimit dhe monitorimit të projekteve për grante shkollore në nivel komune dhe shkolle, ashtu si paraqitet në DGSH. Aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore janë dhënë në vijim:
 - 1.1. Bashkëpunëtori profesional i terrenit do ta menaxhojë mbështetjen profesionale në terren dhe do ta monitorojë zbatimin e secilit projekt për grante shkollore.
 - 1.2. DKA-ja, e mbështetur nga bashkëpunëtori profesional, do t'i rishikojë dhe auditojë rregullisht financat dhe menaxhimin e granteve shkollore, si dhe do ta njoftojë EKP-në për çfarëdo parregullsie.
 - 1.3. BPT-ja, në konsultim me DKA-në, do t'i ndihmojë shkollat me rastin e përgatitjes së raporteve të progresit dhe raporteve përfundimtare, duke përfshirë edhe raportet financiare të cilat do t'i dorëzohen EKP-së.

Neni 8
Bashkëpunimi me EKP-në

1. EKGSH-ja ofron lidhshmëri mes të EKP-së dhe shkollave, të cilat i zbatojnë projektet për grante shkollore. Bashkëpunëtori profesional do të jetë përgjegjës për mbështetjen dhe monitorimin e projekteve.

Neni 9

1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, shfuqizohen të gjitha dispozitat që e kanë rregulluar këto çështje më parë.

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Enxher Hoxhaj, Ministër